

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“PRISHJE DHE TRANSPORTIM TE INERTEVE TE GJENERUARA NE KUADER TE PROCESIT TE RINDERTIMIT, BASHKIA VORE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45210000-2 - Punime ndërtimi,

VLERA E FONDIT LIMIT:

9 771 389 (nente milion e shtateqind e shtatedhjete e nje mije e treqind e tetedhete e nente)
Lekë, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*
- c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;*
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;*
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;*
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;*
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"si dhe nenit

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2019,2020 dhe 2021**,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë referuar nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare **2019,2020 dhe 2021**, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarish, por me kohështirje tre vjecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretish niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019,2020 dhe 2021**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin **2022** duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1 germa a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.. Në rastin kur operatoret ekonomik, anëtarë të

një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa /b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore,
 - Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore,
 - Akt kolaudim i objekti;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, Neni 42. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

AK ka kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

2.3.2 Operatorët ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

N.S - 1A Punime për prishjen e ndërtesave

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja në këte formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.S - 1A (Punime për prishjen e ndërtesave)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me prishjen e ndërtesave, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë e mësipërme.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **8 persona**. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç” si dhe referuar Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për perballimin e fatkeqesise natyrore”, Neni 42.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe do të realizohet brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 8 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.4 - Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

Shënim: Në fazën e detyrës operatorit ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.4 janë të paangazhuar në kontrata të tjera

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c” dhe në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për perballimin e fatkeqesive natyrore”, Neni 42.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin e Punimeve, Specifikimet Teknike rezulton se është e domosdoshme që Ofertuesi të ketë pjesë të stafit 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi, pasi në preventivin e Punimeve ka zëra pune të cilat shtrojnë nevojën për prezencën e Inxhinierit të Ndërtimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj.
- **Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”; në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“; si dhe në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për perballimin e fatkeqesive natyrore”, Neni 42.
- Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më

lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës manovrator dhe 3 (tre) punonjë shofer , për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”; si dhe ne mbështetje te Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Per perballimin e fatkeqesise natyrore”, Neni 42.

AK duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator dhe shofer me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Fadrome me goma	Cope	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtes 20-30 ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me zinxhirë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhirë me krahë 18 metra	Copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Matrapik	Cope	1	Në pronësi ose me qera
6	Autobot Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; fotot perkatese ku te duket qarte targa;
- Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per objektin e procedures per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot ku të duket qarte dhe shërbimi i tij, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe referuar Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e fatkeqesive natyrore”, Neni 42. Nëpërmjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi.

2.3.8 Operatori ekonomik të disponojë Licencë QKL III.2.B, Grumbullim, Transportim, Ruajtje e mbetjeve jo të rrezikshme.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a/c dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/a/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve për të cilën është e domosdoshme licenca me kategori III.2.B

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë :

ISO 9001:2015	Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
ISO 14001:2015	Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
ISO 45001-2018	Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë që merr persiper, me mjetet e veta depozitim të inerteve në piken perkatese.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6 germa “d”,

Njësia e Prokurimit: